



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 208 Akti

Nr. 378 Vendimi
Tiranë, më 30.4.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 28.4.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Evjeni Sinojmeri**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç, dhe nenet D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.11.2018, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Trupi gjykues i caktuar për shqyrtimin e çështjes është i përbërë nga komisionerët Suela Zhegu relatore, Genta Tafa (Bungo) dhe Alma Faskaj anëtare. Komisionere Alma Faskaj ka deklaruar konfliktin e interesit me subjektin e rivlerësimit. Me vendimin nr. 48, datë 18.10.2019, të Komisionit është zgjedhur me short trupi gjykues për të shqyrtuar kërkesën e znj. Alma Faskaj për dorëheqje nga shqyrtimi i çështjes. Në përfundim, trupi gjykues ka pranuar dorëheqjen e znj. Alma Faskaj nga shqyrtimi i çështjes ndaj subjektit Evjeni Sinojmeri. Në vijim të kësaj procedure znj. Alma Faskaj u zëvendësua me anëtares zëvendësuese të trupit gjykues. znj. Brunilda Bekteshi.

3. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.10.2019 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues komisionere Genta Tafa (Bungo). Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

4. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si KLGJ).

6. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

➤ *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*

¹Me shkresën me nr. *** prot., datë 16.5.2018.

- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

7. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Evjeni H Sinojmeri.*

8. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës nr. 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

9. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

10. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 7.4.2021, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

11. Për një proces të rregullt ligjor, znj. Evjeni Sinojmeri, i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues; si dhe (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Në datën 8.4.2021 për sa rezultoi nga hetimi administrativ i procesit të rivlerësimit, subjektit iu caktua një afat kohor deri në datën 23.4.2021, kohë për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

12. Subjekti me njoftimin e elektronik të datës 8.4.2021, është njoftuar mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

13. Subjekti u njoh me rezultatet paraprake të hetimit dhe, në përgjigje të tyre, me shpjegimet e paraqitura në datën 21.4.2021, ka informuar mbi pamundësinë objektive për mosparaqitjen e saj në Shqipëri, për shkak të situatës së pandemisë globale, pasi i rrezikohej shëndeti. Ndër të tjera, subjekti ka shpjeguar se në këto kushte, në mungesë të saj dhe të familjarëve të saj, e ka të pamundur të administrojë dokumentacion dhe prova që i takojnë një periudhe 30-vjeçare për të provuar pretendime e saj.

²Me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar me vendimin nr. **, datë 30.3.2021, të KDZH-së.

³Me shkresën nr. *** prot., datë 23.4.2019.

14. Subjekti në mbështetje të shpjegimeve të saj, nuk ka paraqitur arsye specifike si në rastin kur pretendoi se nuk mundi të sigurojë prova përmes një përfaqësuesi ligjor apo kur pretendoi pamundësinë objektive për shkak të arsyeve shëndetësore, pretendime këto që ngelën në nivel deklarativ dhe të paprovuara me dokumentacion nga subjekti. Subjekti nuk paraqiti shpjegime dhe prova, në kundërshtim të rezultateve të hetimit të dërguar nga Komisioni.

15. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pas shqyrtimit të çështjes në tërësi, në mungesë të një dokumentacioni ligjor justifikues për të mbështetur pretendimet e saj, si gjatë hetimit dhe në parashtrime, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

16. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin elektronik të datës 23.4.2021.

17. Seanca dëgjimore u zhvilluan në datën 28.4.2021, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

18. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit personalisht, apo me ndonjë përfaqësues, për t'u shprehur në lidhje me rezultatet paraprake të hetimit dhe për procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar rregullisht nga Komisioni, në lidhje me të gjitha hapat procedurale të ndjekura në lidhje me procesin e saj të rivlerësimit. Me e-mail-in e datës 29.5.2020, subjektit i është kërkuar nga Komisioni, që të japë informacion në lidhje me udhëtimet e saj, si dhe shpenzimet e këtyre udhëtimeve.

20. Subjekti në përgjigjet e datës 4.6.2020, ka informuar se: *"... me gjithë përpjekjet për të përfunduar në kohë dhe me saktësi detyrën e ngarkuar prej Komisionit, e kam të pamundur të kthej përgjigje për shkak se pas përfundimit të një periudhe ndërprerje nga ushtrimi i detyrës me leje nga ish-KLD-ja, vazhdoj të mbetem jashtë vendit, e bllokuar nga situata e pandemisë. Kjo e bën të pamundur aksesimin dhe ballafaqimin me dokumentet e nevojshme për plotësimin e tabelës, të cilat mund t'i siguroj vetëm në Shqipëri.*

Në këtë situatë pamundësie objektive, do të kërkoja mirëkuptimin tuaj për të vazhduar komunikimin në një moment të mëvonshëm, kur të jem kthyer në Shqipëri".

21. Komisioni ka vijuar komunikimin me subjektin⁴, duke i kërkuar të shpjegojë dhe të depozitojë dokumentacion provues, në lidhje me shkakun ligjor të mosparaqitjes së saj në punë, për të ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, nga data 1 prill 2020 e në vijim. Gjithashtu, Komisioni i ka kërkuar të depozitojë kopje të kërkesës për leje, drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor.

22. Subjekti nuk i është përgjigjur kërkesës së mësipërme. Më tej, subjektit i janë dërguar nga Komisioni pyetësor shtesë, për të dhënë informacion dhe depozituar dokumentacion, duke i theksuar dhe mundësinë e saj që të përfaqësohej me një përfaqësues ligjor.

⁴Me pyetësorin dërguar nëpërmjet postës elektronike të datës 19.10.2020.

23. Subjekti nuk i është përgjigjur kërkesave të Komisionit, duke mos iu dhënë përgjigje shteruese pyetësorëve dhe duke mos bashkëpunuar në procesin e hetimit administrativ.

24. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, nuk ka paraqitur shkaqe të arsyeshme mbështetur në dokumentacion provues, ku të mbështesë pretendimet e saj, si dhe nisur nga fakti që procesi i rivlerësimit kalimtar është një proces kushtetues dhe i mandatuar, Komisioni ka vijuar me procesin e rivlerësimit, si dhe me hetimin administrativ duke hartuar rezultatet e hetimit administrativ.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

25. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

26. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

27. Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

28. Ndërsa, sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

29. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

30. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar, *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGj-ja;
- g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;

h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

31. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Evjeni Sinojmeri, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, u krye mbi bazën e tri kriterëve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore; (ii) burimet e krijimit të kësaj pasurie; (iii) të ardhurat; (iv) shpenzimet; si dhe (v) mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konfliktin e interesit.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, shtojca 2, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017, në zbatim të ligjit, subjekti ka deklaruar:

1. Apartament banimi me sip. 103.4 m², ndodhur në “Rrugën e Elbasanit”, Tiranë

Vlera e deklaruar: 5.000.000 lekë.

Pjesa në përqindje: subjekti zotëron ½ pjesë.

Burimi i krijimit: nuk është deklaruar burimi i krijimit për këtë pasuri.

Deklarimi në DPV: në vitin 2004, nuk është deklaruar burimi i krijimit për këtë pasuri.

Mënyra e fitimit: me kontratën e shitblerje nr. ***, datë 8.10.2003.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- kontratë shitje të pasurisë së paluajtshme nr. ****, datë 8.10.2003, me palë shitëse shtetasin H.K/babai i subjektit dhe palë blerëse shtetasen Evjeni Sinojmeri, për blerjen e një apartamenti me sip. 103.4 m², me vendndodhje në “Rr e E”, Tiranë, në çmimin 5.000.000 lekë. Kjo shumë do t’i paguhet shitësit prej Bankës së Kursimeve në momentin e lëvrimin të kredisë në emër të blerësit;
- vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 1.7.2004, të apartamentit të regjistruar në emër të shtetasen Evjeni Sinojmeri, me sip. 103.4 m², ndodhur në z. k. ***, “Rr e E”.
- nxjerrje të aktivitetit të shlyerjes së kredisë nga “Raiffeisen Bank” në datën 17.10.2016, lidhur me pagesat që subjekti duhet të kryejë gjatë periudhës 11.9.2004 – 11.6.2029. Sipas këtij dokumenti rezulton se, pasi ka shlyer këstin e datës 11.1.2017, shuma e mbetur pa shlyer është 2.962.993 lekë (aneks nr. */**);
- nxjerrje llogarie në emër të subjektit nga “Raiffeisen Bank”, lidhur me shlyerjet e kësteve të kredisë me gjendje në datën 17.1.2017 në shumën -5.79 lekë (aneks nr. */**).

1.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

ASHK – Tirana Jug⁵ konfirmon se në emër të subjektit Evjeni Sinojmeri është regjistruar pasuria apartament me sip. 103.2 m², nr. ****+*_***, z. k. ****, e blerë me kontratë shitblerje në çmimin 5.000.000 lekë, e cila do t’i paguhet shitësit prej Bankës së Kursimeve, në momentin që do të lëvrohet kredia. Kopje karte, e cila në seksionin e hipotekave konfirmon se kjo pasuri është e bllokuar në favor të Bankës së Kursimeve me kontratë hipoteke nr. ****, datë 7.7.2004.

⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.10.2019.

“Raiffeisen Bank”⁶ konfirmon se shtetasja Evjeni Sinojmeri rezulton kredimarrëse pranë kësaj banke, sipas kontratës së huas për blerje banese nr. ***, datë 7.7.2004, me palë huadhënëse Bankën e Kursimeve, për shumën 5.000.000 lekë, me interes 3% dhe me afat kthimi 300 muaj/25 vjet.

Ka rezultuar se pasuria e blerë nga subjekti është hipotekuar në favor të “Raiffeisen Bank”, sipas kontratës së hipotekimit nr. ****, datë 7.7.2004.

Nga aktet e depozituar nga banka rezulton një dokument “urdhërpagesë”, i Bankës së Kursimeve, me urdhërues znj. Evjeni Sinojmeri dhe përfitues z. H. K të shumës 5.000.000 lekë, në datën 12.7.2004.

OSHEE-ja⁷ informon se në emër të shtetasës Evjeni Sinojmeri, referuar sistemit të faturimit, në adresën “Rr e E”, identifikohet kontrata e furnizimit me nr. TR*B***, në kategorinë familjare, në ndërtesën e shoqërisë “F” sh.p.k.

1.2 Analiza e fakteve

Pasuria apartament ndodhur në “Rr e E”, Tiranë, është blerë me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 8.10.2003. Subjekti në DPV-në e vitit 2004, ka deklaruar si adresë banimi “Rr e E”, pallati “T *”, Tiranë.

Subjekti, me kontratën nr. ***, datë 7.7.2004, ka përfituar kredi me kushte lehtësuese, nga Banka e Kursimeve, në përputhje me VKM-në nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”.

Ka rezultuar se subjekti në vitin 2000 kishte bërë disa pagesa për blerjen e apartamentit të trajtuar në pikën 2, në vijim të vendimit, si dhe pagesa për porositjen e apartamentit trajtuar në pikën 4, në vijim të vendimit, në vitin 2004, ndërkohë në momentin e përfitimit të kredisë nuk ka pasur në Tiranë asnjë pasuri në pronësi.

Analiza financiare

Nga analizimi i dokumentacionit bankar ka rezultuar se pasuria apartament është blerë nga subjekti tërësisht me kredi bankare. Nga kontrata rezulton se kjo hua bazohet në VKM-në nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politik dhe nëpunësve të Administratës shtetërore”, gjithashtu, evidentohen pagesa mujore të kryera nga subjekti në favor të bankës nga viti 2004 – 2016.

✓ **Nga analiza e kryer ka rezultuar se subjekti me kredinë e marrë ka likuiduar plotësisht vlerën e pasurisë apartament.**

1.3 Analiza ligjore

Trupi gjykues, pasi analizoi dokumentacionin e administruar gjatë hetimit, konstatoi se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* burimin e krijimit për pasurinë apartament, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Nga hetimi ka rezultuar se kredia bankare ka shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie.

2. Apartament banimi me sip. 59.80 m², ndodhur në “Rr e E”, Tiranë

Vlera e deklaruar: 26.855 USD.

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019.

⁷ Me shkresën nr. **** prot., datë 15.10.2019.

Pjesa në përqindje: subjekti zotëron ½ pjesë, në bashkëpronësi me bashkëshortin.
Burimi i krijimit: nuk është deklaruar burimi i krijimit në deklaratën *Vetting*.
Deklarimi në DPV: në DPV-në e vitit 2012, nuk është deklaruar burimi i krijimi për këtë pasuri.
Mënyra e fitimit: me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 7.1.2012.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- kontratë shitblerje nr. ***, datë 7.1.2012, me palë shitëse shoqërinë “F. C” sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasen Evjeni Sinojmeri, për blerjen e një apartamenti me sip. 59.8 m², nr. ****+*-.**, në “Rr e E”, Tiranë, në çmimin 26.855 USD. Shuma e blerjes së kësaj pasurie është likuiduar nga ana e blerëses në favor të shitësit jashtë zyrës noteriale. Subjekti nuk ka depozituar në dosje ndonjë dokument të provojë pagesën e kryer;
- certifikatë pronësie të pasurisë “apartament”, me sip. 59.8 m², regjistruar me nr. ***-**, Tiranë, në emër të shtetasës Evjeni Sinojmeri, lëshuar në datën 23.1.2012.

2.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

ASHK – Tirana Jug⁸ konfirmon se në emër të subjektit Evjeni Sinojmeri është e regjistruar pasuria apartament me sip. 59.8 m², nr. ****+*-.**, blerë me kontratë shitje në çmimin 26.855 USD, e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Bashkëngjitur praktika e regjistrimit të subjektit dhe pronarit të mëparshëm.

Shoqëria “F. C”⁹ sh.p.k. ka informuar se pagesat për blerjen e kësaj pasurie nga znj. Evjeni Sinojmeri, janë kryer sipas planit vijues: paguar *cash* në datën 17.1.2000, shumën 10.000 USD; paguar *cash* në datën 30.10.2000, shumën 10.000 USD; paguar *cash* shumën 6.855 USD, pra, në total paguar shuma 26.855 USD.

OSHEE-ja¹⁰ ka informuar se në emër të znj. Evjeni Sinojmerit, referuar sistemit të faturimit, në adresën “Rr e E”, identifikohet kontrata e furnizimit me nr. TR*B0****, në kategorinë familjare, në ndërtesën e shoqërisë “F. C” sh.p.k.

- ⊗ Megjithëse shoqëria e ndërtimit ka informuar mbi pagesa të kryera në vitin 2000, kjo pasuri është deklaruar nga subjekti për herë të parë në DPV-në e vitit 2012.

Referuar dokumentacionit të administruar në dosje, provohet se ka paguar në vitin 2000 shumën *cash* prej 20.000 USD. Shuma prej 6.855 USD, nuk provohet se në cilën datë është paguar. Referuar kontratës së shitblerjes së datës 7.1.2012, kjo shumë mund të jetë paguar në këtë datë, si këst i fundit, në dorëzim të apartamentit nga firma ndërtuese.

Nga verifikimi i deklarimeve ka rezultuar se:

- ⊗ Nuk janë deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2003, pagesat e kryera për këtë apartament.
- ⊗ Në DPV-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar “*pakësim të gjendjes cash të krijuar në vitet më parë në shumën 26.855 USD për blerjen e apartamentit*”, ndërkohë që pagesat janë bërë në vitin 2000, në shumën 20.000 USD.

2.2 Analiza financiare

⁸ Me shkresën nr. **** prot., datë 22.10.2019.

⁹ Me shkresën nr. **** prot., datë 7.10.2020.

¹⁰ Me shkresën nr. **** prot., datë 15.10.2019.

Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e depozituar nga subjekti në ILDKPKI, por edhe në dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ, kreu analizën financiare për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit për pagesat në shumën 20.000 USD në vitin 2000, si dhe në shumën 6.855 USD në janar të vitit 2012.

a. Analiza financiare për periudhën 1985 – 2000, për pagesën në shumën 20.000 USD

Në analizën financiare janë marrë në konsideratë të ardhurat e ligjshme të subjektit dhe bashkëshortit, sipas dokumentacion ligjor, në përputhje me përcaktimet në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, si më poshtë:

- Të ardhura si prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për periudhën 18.8.1985 – 1.02.1990, në shumën 46.440 lekë.
- Të ardhura si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për periudhën 2.2.1990 – 1.4.1994, në shumën 167.214 lekë.
- Të ardhura si gjyqtare për periudhën 26.4.1994 – 8.2.1996, në shumën 296.949 lekë.
- Subjekti ka pretenduar se ka realizuar të ardhura si notere gjatë periudhës 8.2.1996 – 31.12.2000, në shumën totale prej 6.000.000 lekë, por që nuk i ka provuar me dokumentacion. Kjo shumë nuk është marrë në konsideratë në analizën paraprake financiare.
- Të ardhurat e bashkëshortit nga puna pranë “***” sh.p.k., për periudhën 1994 – 1999, në shumën 755.942 lekë.

Në lidhje me shpenzimet e jetesës për periudhën 1985 – 2000, referuar vendimit nr. 19/2019, (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, janë konsideruar në masën 66% të të ardhurave.

Përshkrimi	Periudha 1985 – 2000
Të ardhura subjekti	510 603
Të ardhura bashkëshorti	755 942
Total të ardhura	1 266 545
Shpenzime jetese	835 920
Pasuri	2 865 200
Rezultati financiar	-2 434 575

- ⊗ Nga analiza financiare e kryer, duket se subjekti dhe bashkëshorti kanë mungesë burimesh të ligjshme për pagesat e kryera në vitin 2000, pasi për këtë periudhë kanë rezultuar me balancë negative në shumën **2.434.575 lekë**.

b. Analiza financiare për pagesën e këstit prej 6.855 USD në datën 7.1.2012

Referuar deklaratimit të subjektit në deklaratën periodike të vitit 2012, specifikohet pakësim i gjendjes *cash*, si dhe kursimeve të deklaruara në vitet e mëparshme në shumën 26.855 USD, ndërkohë që referuar hetimit të kryer shumë prej 20.000 USD ishte paguar në vitin 2000.

Për pagesën e mbetur në shumën prej 6.855 USD nga çmimi i blerjes, të kryer në datën 7.1.2012, Komisioni verifikoi gjendjen *cash* në fund të vitit 2011, e cila ka rezultuar në shumën 3.900.000 lekë.

- ✓ Duket se subjekti ka pasur mjaftueshëm gjendje *cash* të deklaruar për ta paguar këstin në shumën 6.855 USD.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri ka rezultuar se subjekti:

- ⊗ Nuk ka deklaruar burimin e krijimit në deklaratën *Vetting*.
- ⊗ Ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e apartamentit në shumën **2.434.575 lekë**.
- ⊗ Ka deklarim të pasaktë për pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie.

Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

2.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit të datës 21.4.2021, ka shpjeguar se që prej momentit të shortimit dhe deri më sot ndodhet në SHBA e bllokuar nga situata e pandemisë dhe nuk ka depozituar asnjë dokumentacion provues për të mbështetur pretendimin lidhur me pamundësinë për t'u paraqitur në detyrë dhe për të qenë pjesë aktive në këtë proces rivlerësimi.

2.4 Analiza ligjore

Komisioni arsyeton se subjekti kishte mundësi të përdorte mjetet ligjore të parashikuara nga nenet 64 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, për caktimin e një përfaqësuesi ligjor, për mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm, sipas udhëzimeve të saj dhe të familjarëve.

Bazuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni, nuk u provuan të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

3. Apartament banimi me sip. 128 m², ndodhur në rrugën "K e P"

Vlera e deklaruar: 57.600 euro.
 Pjesa në përqindje: zotëron ½ pjesë.
 Burimi i krijimit: subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi në deklaratën *Vetting*.
 Deklarimi në DPV: në DPV-në e vitit 2015, subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi për këtë pasuri.
 Mënyra e fitimit: me kontratën nr. ***, datë 31.12.2015.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. ****, datë 31.12.2015, me palë shitëse shoqërinë "A-T Co" sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasen Evjeni Sinojmeri, për blerjen e një apartamentit me sip. 128 m², të ndodhur në Rrugën "K e P", Tiranë. Në kontratë përcaktohet se palët në datën 12.12.2004, kanë lidhur një kontratë sipërmarrjeje nr. ***, duke vendosur si çmim shitje të këtij apartamenti vlerën 57.600 euro. Palët deklarojnë se kjo vlerë është shlyer më parë midis tyre, jashtë zyrës noteriale, sipas afateve të përcaktuara në këtë kontratë dhe nuk kanë më detyrime midis tyre;
- certifikatë pronësie të pasurisë "apartament" me sip. 128 m², regjistruar me nr. ***+*-***, në Tiranë, në emër të shtetasës Evjeni Sinojmeri, lëshuar më 13.1.2016.

3.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

ASHK – Tirana Jug¹¹ konfirmon se në emër të shtetases Evjeni Sinojmeri është e regjistruar pasuria apartament me sip. 128 m², nr. ***+*-***, z. k. ****, e blerë me kontratë shitjeje me vlerë 57.600 euro. Rezulton se çmimi është shlyer brenda afateve të përcaktuara në kontratën nr. ****, datë 12.12.2004, para noterës M.Sh. Bashkëngjitur praktika e regjistrimit ku përfshihet edhe kontrata e sipërmarrjes.

Bashkëlidhur përgjigjes së ASHK-së Tiranë rezulton edhe një kontratë sipërmarrje për ndërtim apartamenti me nr. ***, datë 12.2.2004, nënshkruar ndërmjet shoqërisë së ndërtimit “A. T” sh.p.k. dhe shtetases Evjeni Sinojmeri, për ndërtimin e një apartamenti 3+1, me sip. 144 m², në çmimin 57.600 euro. Në kontratë është parashikuar mënyra e pagesës së çmimi si vijon:

- me nënshkrimin e kontratës do të paguhej 35% e vlerës së apartamentit, e barabartë me 20.160 euro;
- me përfundimin e karabinasë do të paguhej 40% e vlerës së apartamentit, e barabartë 23.040 euro;
- me fillimin e rafiniturës do të paguhej 20% e vlerës së apartamentit, e barabartë me 11.520 euro;
- me dorëzimin e çelësave në dorë do të paguhet 5% e vlerës së apartamentit e barabartë me 2.880 euro.

Në dokumentacionin e administruar në dosje nuk rezulton asnjë dokument, për të provuar datat e kryerjes së pagesave.

Në DPV-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar se ka shtuar pasurinë me një apartament me sip. 144 m², në rrugën “K e P”, Tiranë, me kontratën e sipërmarrjes, në shumën 57.600 euro.

Referuar pagesave të parashikuara në kontratën e sipërmarrjes, subjekti nuk ka deklaruar në DPV-të periodike mbi këstet e paguara sipas kësaj kontrate.

OSHEE-ja¹² informon se në emër të shtetases Evjeni H Sinojmerit, referuar sistemit të faturimit në adresën “K e P”, njësia ***, identifikohet kontrata e furnizimit me nr. TR*O****, në kategorinë familjare, në ndërtesën e shoqërisë “A.T Co” sh.p.k.

3.2 Analiza financiare

Subjekti e ka deklaruar pasurinë në DPV-në e vitit 2006. Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar edhe blerjen e një apartamenti në Plazh, Durrës, me vlerë 30.000 euro.

Për blerjen e dy pasurive të sipërcituara, subjekti ka deklaruar se: “ (i) pakësim i të gjithë gjendjes së kursimeve cash të deklaruar në vitet më parë në shumat: 30.000 USD, 500.000 lekë dhe 5.200.000 lekë; dhe (ii) kursimet e vitit 2006 në shumën 1.300.000 lekë dhe një hua marrë babait në shumën 6.000 euro”.

Nga verifikimi i deklarimeve të gjendjes cash të deklaruar, ndër vite, ka rezultuar se shuma 5.200.000 lekë është deklaruar nga subjekti në vitin 2005, nga të cilat 3.900.000 lekë kanë rezultuar si të ardhura nga shitja e pasurisë truall plus ndërtim në Gjirokastër dhe shuma prej 1.300.000 lekësh kursime nga të ardhurat e vitit. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, duket se në vitet 2000 – 2003, është kryer një investim një kat plus

¹¹Me shkresën nr. *** prot., datë 22.10.2019.

¹²Me shkresën nr. *** prot., datë 15.10.2019.

karabinaja e katit të dytë. Nuk ka asnjë informacion se sa ka kushtuar ky investim dhe sa ka qenë pjesa takuese e subjektit dhe bashkëshortit.

Referuar dokumentacionit në dosje, kontrata e sipërmarrjes është nënshkruar në vitin 2004, vit në të cilin kjo kontratë ka parashikuar pagimin e shumës 20.160 euro dhe kështu e tjera në vijim sipas kryerjes së punimeve.

Nuk është e qartë se kur janë paguar kështu e kësaj pasurie. Në mungesë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, në analizën e kryer nga Komisioni, kësti prej 20.160 euro është pasqyruar në vitin 2004 dhe kështu e mbetura në vitin 2006, vit në të cilin subjekti e ka deklaruar të pakësuar gjendjen *cash* për blerje të apartamenteve.

a. Analiza financiare për pagesën e kështit të parë në shumën 20.160 euro në datën 12.2.2004

Në analizën financiare të kryer në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, ku parashikohet se shuma prej 20.160 euro do të paguhet në këtë datë, janë përfshirë në tabelën vijuese:

- të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit për dy muaj;
- shpenzimet e jetesës për muajin janar – 12 shkurt;
- gjendja e likuiditeteve bankare ka rezultuar 0 (zero);
- shumat *cash* të deklaruara nga subjekti.

Përshkrimi	12.2.2004
Pasuri apartament me sip. 128 m ²	2 555 078
Diferencë likuiditeti	-11 144
Gjendje <i>cash</i>	3 260 700
Likuiditete në bankë	-
Pasuri <i>neto</i>	2 543 934
Të ardhura subjekti	247 856
Të ardhura bashkëshorti	54 584
Shpenzime jetese	46 932
Shpenzime udhëtimi	-
Rezultati	-2 288 426

⊗ **Nga analiza e kryer, duket se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi financiare për të paguar me burime të ligjshme kështin e parë të apartamentit, pasi ka rezultuar me balancë negative në shumën 2.288.426 lekë.**

b. Analiza financiare për pagesën në shumën 37.440 euro në vitin 2006

Referuar deklaratimit të subjektit në deklaratën periodike të vitit 2006, ku si burim për blerjen e apartamentit kanë shërbyer kursimet *cash* të deklaruara në vitet më parë, Komisioni ka konstatuar se gjendja *cash* në fund të vitit 2005 ka rezultuar në shumën 8.960.700 lekë.

✓ Duket se subjekti ka pasur mjaftueshëm gjendje *cash* të deklaruar për të kryer pagesën.

Për këtë pasuri nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se:

- ⊗ Në deklaratën *Vetting* nuk është deklaruar nga subjekti burimi i krijimit të kësaj pasurie.
- ⊗ Subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për të paguar kështin e parë të apartamentit, në shumën 2.288.426 lekë.

Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kalua barrën e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

3.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti në përgjigjen e rezultateve të hetimit të datës 21.4.2021, nuk ka dhënë asnjë shpjegim në lidhje me pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

3.4 Analiza ligjore

Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Për sa më sipër, subjekti, as gjatë hetimit por edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk provoi të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezultoi të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

4. Garazh me sip. 19.1 m², ndodhur në rrugën “K e P” Tiranë

Vlera e deklaruar: 700.000 lekë.

Pjesa në përqindje: zotëron ½ pjesë.

Burimi i krijimit: subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi.

Deklarimi në DPV: në DPV-në e vitit 2004, subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi për këtë pasuri.

Mënyra e fitimit: kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 23.9.2004. Regjistruar në ZVRPP me nr. ****, datë 20.10.2004.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme garazh nr. *****, datë 23.9.2004, me palë shitëse shoqërinë “A-T” sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasen Evjeni Sinojmeri, për blerjen e garazhit me nr. **, me sip. 19.1 m², i ndodhur në rrugën “K e P”, Tiranë, në vlerën 700.000 lekë, shumë e cila është likuiduar;
- vërtetim hipotekor nr. ***, datë 20.10.2004, për garazhin me nr. **, i regjistruar në emër të shtetasës Evjeni Sinojmeri, me sip. 19.1 m², i ndodhur në z. k. ***, rruga “K e P”.

4.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

ASHK Drejtoria Tirana Jug¹³ informon se për pasurinë në z. k. ***, me sip. 19 m², është e pamundur të specifikohen të dhënat.

ZVRPP-ja Tiranë¹⁴ konfirmon se në emër të shtetasës Evjeni Sinojmeri është e regjistruar pasuria garazh me nr. ***+*-G**, me sip. 19.1 m² e ndodhur në z. k. ***, e blerë me kontratë shitje në vlerën 700.000 lekë.

OSHEE-ja¹⁵ informon se në emër të shtetasës Evjeni H Sinojmeri, referuar sistemit të faturimit në adresën rruga “K e P”, njësia ***, identifikohet kontrata e furnizimit me nr. TR*O***, në kategorinë familjare, në ndërtesën e shoqërisë “A. T. Co” sh.p.k.

¹³Me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2020,

¹⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2018, drejtuar ILDKPKI-së.

¹⁵Me shkresën nr. **** prot., datë 15.10.2019.

4.2 Analiza financiare

Komisioni kreu një analizë të të dhënave financiare për mundësinë e blerjes së garazhit me burime të ligjshme.

Subjekti nuk ka deklaruar burim për blerjen e kësaj pasurie, gjithashtu, në fund të vitit 2004 ka deklaruar shtim të kursimeve *cash* në shumën 500.000 lekë.

Gjatë vitit 2004 duket se subjekti ka paguar këstin e parë të apartamentit në datën 12.2. 2004, të trajtuar më sipër në pikën 3 të vendimit.

Në analizën financiare, si më poshtë, janë konsideruar të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortit për shtatë muaj shpenzimet e jetesës, si dhe të udhëtimeve për periudhën e analizuar.

Sa i përket gjendjes së kursimeve *cash*, referuar deklarimit të subjektit për shtim të kursimeve në shumën 500.000 lekë gjatë vitit, është bërë një përlogaritje në bazë të muajve në të cilën janë krijuar të ardhurat.

Gjatë hetimit ka rezultuar se subjekti ka blerë tri pasuri të paluajtshme në vitin 2004. Pasuria e blerë në datën 12.2.2004 është analizuar në pikën 3 të raportit. Ka rezultuar se në datë 1.10.2004, një javë pas blerjes së garazhit, subjekti ka paguar shumën prej 28.000 euro për blerjen e një apartamenti në rrugën “Q.S”, Tiranë, pasuri e pasqyruar në pikën 5 të këtij raporti.

Për sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar që në analizën financiare të përfshijë periudhën 13.2.2004 – 1.10.2004, duke përfshirë të dyja pasuritë e blera, si dhe ardhurat dhe shpenzimet brenda këtij afati kohor sipas tabelës në vijim.

Përshkrimi	Periudha 13.2.2004 – 1.10.2004
Pasuri apartament	3 548 720
Garazh	700 000
Diference likuiditeti	375 000
Gjendje <i>cash</i>	3 635 700
Likuiditete banke	-
Pasuri <i>neto</i>	4 623 720
Të ardhura subjekti	943 330
Të ardhura bashkëshorti	191 044
Shpenzime jetese	255 633
Shpenzime udhëtimi	514 564
Rezultati	-4 259 543

Referuar analizës financiare, rezultoi se subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për krijimin e pasurive të blera në vitin 2004 dhe për të mbuluar shpenzimet, pasi ka rezultuar me një balancë negative në shumën **4.259.543 lekë**.

Për sa më sipër, për këtë pasuri rezultoi se:

- ⊗ Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.
- ⊗ Subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie.

Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D të Kushtetutës.

4.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti në përgjigjen e rezultateve të hetimit të datës 21.4.2021, nuk ka dhënë shpjegime, si dhe nuk ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me burimin e krijimit për këtë pasuri.

4.4 Analiza ligjore

Subjekti as gjatë hetimit, por dhe pas kalimit të barrës së provës nuk provoi bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

5. Apartament banimi me sip. 66.2 m², në rrugën “Q. S”, Tiranë

Vlera e deklaruar: 28.000 euro.

Pjesa në përqindje: zotëron ½ pjesë.

Burimi i krijimit: subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi në deklaratën *Vetting*.

Deklarimi në DPV¹⁶: nuk është deklaruar burim krijimi.

Mënyra e fitimit: me kontratën ***, datë 18.12.2015.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme nr. ***, datë 18.12.2015, me palë shitëse shoqërinë “D.*.S” sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasin E.S, për blerjen e një apartamenti me sip. 66.2 m², i regjistruar me nr. ***+*-* , z. k. ***, vol. ***, f. ***, i ndodhur në rrugën “Q.S”, Tiranë. Çmimi i shitjes në shumën 28.000 euro është shlyer tërësisht nga blerësi në bazë të kontratës së shitblerjes me kusht nr. ****, datë 13.11.2004;
- certifikatë pronësie të pasurisë “apartament” me sip. 66.2 m², i regjistruar me nr. ***+*-* , Tiranë, në emër të shtetasit E.S e lëshuar në datën 6.1.2016.

5.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

ASHK Tirana Veri¹⁷ ka konfirmuar se në emër të shtetasit E.S është regjistruar pasuria apartament me nr. ***+*-* , me sip. 66.2 m², e blerë me kontratë shitje në çmimin 28.000 euro. Rezulton se çmimi është shlyer tërësisht jashtë zyrës noteriale në bazë të kontratës së shitblerjes me kusht nr. ****, datë 13.11.2004.

Në përgjigjen e ASHK-së rezulton një kontratë shitblerje me kusht, datë 13.11.2004, sipas të cilës bashkëshorti i subjektit ka blerë apartament me sip 73.5 m², rrugën “Q. S”, Tiranë, me vlerë 28.000 euro. Referuar kontratës, çmimi është likuiduar tërësisht në dorë jashtë zyrës noteriale.

Gjithashtu, në dosje rezulton edhe deklarata noteriale, datë 1.10.2004, nënshkruar nga shtetasit A.K dhe E.S, sipas së cilës A. K deklaron se i ka dhënë kunatit, E.S, shumën 28.000 euro, për blerjen e kësaj pasurie për interes dhe në llogari të tij.

Në deklaratën noteriale nga z. E. S është deklaruar se: *“Pavarësisht se veprimet me shoqërinë deri në momentin e shitjes do t’i kryej unë, kontrata për kalimin e pronësisë do nënshkruhet nga vetë A.K”*. Kjo pasuri, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 18.12.2015, ka kaluar në pronësi të z. E.S.

¹⁶Në DPV-në vitit 2009.

¹⁷Me shkresën nr. **** prot., datë 23.10.2019.

Nga aktet e dosjes nuk rezulton e provuar se si i ka marrë z. E.S, këto shuma nga vëllai i subjektit.

Referuar kontratës së shitblerjes, kjo pasuri ka kaluar në pronësinë e z. E.S në vitin 2015.

Në DPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar: *“Blerë një apartament me kontratë sipërmarrje (titulluar shitblerje me kusht). Apartamenti ndodhet në rrugën ‘Q.S’, Tiranë, mban nr. *, në katin e pare dhe ka një sipërfaqe 73.5 m², i paregjistruar”*. Subjekti ka shpjeguar në vijim: *“Pakësuar pasuria me 33.000 euro, të përdorura për blerjen e apartamentit dhe të një automjeti 5.000 euro për djalin E.S”*.

Në DPV-në e vitit 2009, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka shpjeguar se: *“Apartamenti që deklarova nuk është deklaruar më parë, pasi është blerë për vëllain tim A. K. Me deklaratën noteriale të datë 1.10.2004, vëllai i ka dhënë bashkëshortit tim E shumën prej 28.000 euro, me qëllim porositjen e këtij apartamenti dhe ka autorizuar që kontratën e sipërmarrjes ta lidhte bashkëshorti im në emër të vet, ndërsa kur të përfundonte ndërtimi, kontratën e shitjes do ta nënshkruante vetë A (vëllai i subjektit). Për arsyet e veta A e mori shumën e dhënë nga E dhe apartamenti do të mbetet në pronësinë tone. Kontrata përfundimtare ende nuk është lidhur pasi tani ka përfunduar ndërtimi dhe nuk është bërë regjistrimi i pronës në ZVRPP”*.

OSHEE-ja¹⁸ informon se në emër të shtetasit E. F.S, referuar sistemit të faturimit në adresën rrugën “Q.S”, Njësia Administrative Nr. *, identifikohet kontrata e furnizimit me nr. TR*A***, në kategorinë familjare, me status aktiv – normal, në kabinën Q. S.

UKT-ja¹⁹ informon se në emër të shtetasit E.F.S, rezulton kontrata e furnizimit me nr. ***-*, për objektin në adresën rrugën “Q.S”, Tiranë, me status aktiv, në kategorinë e konsumatorëve familjarë, me detyrime të likuiduara.

5.2 Analiza financiare

Nga analizimi i akteve të administruara në dosje ka rezultuar se:

- Subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2004 pagesën e kryer në datën 1.10.2004 për apartamentin.
- Nuk është deklaruar në vitin 2004 deklarata noteriale e nënshkruar para noterit midis z. E.S dhe z. A.K/vëllai i subjektit.
- Nuk provohet që z. E.S të ketë përfituar nëpërmjet ndonjë transferte bankare, shumën e deklaruar si të dhënë nga z. A. K dhe as kthimin mbrapsht të kësaj shume.
- Subjekti nuk ka deklaruar burimet e ligjshëm për shumën 28.000 euro nga z. A. K.
- Kontrata e sipërmarrjes dhe likuidimi total është kryer nga bashkëshorti i subjektit.
- Sipas deklarimeve periodike vjetore, subjekti e ka deklaruar në vitin 2009 dhe jo në vitin 2004, pasi vetëm në 2009 kishte mjaftueshëm *cash* të deklaruar, për blerjen e kësaj pasurie.
- Kontrata e shitblerjes është nënshkruar nga bashkëshorti dhe përfitues ka qenë subjekti dhe bashkëshorti.

¹⁸Me shkresën nr. **** prot., datë 15.10.2019.

¹⁹Me shkresën nr. K-*** prot., datë 11.10.2019.

Në analizë të dokumentacionit të sipërcituar të deklarimeve dhe mosdeklarimeve të subjektit, ndër vite, blerja e apartamentit në rrugën “Q. S” është pasqyruar në vitin 2004 sipas tabelës financiare të kryer për pasurinë*.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri rezultoi se:

⊗ Referuar analizës financiare (në tabelën e pasurisë 4), subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi financiare të ligjshme për të blerë pasurinë, pasi ka rezultuar me një balancë negative prej **4.259.543 lekë**, për vitin 2004.

⊗ Nuk janë deklaruar burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Kushtetutës.

5.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti në përgjigjen e rezultateve të hetimit të datës 21.4.2021, nuk ka dhënë shpjegime, si dhe nuk ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me burimin e krijimit për këtë pasuri.

5.4 Analiza ligjore

Për sa më sipër, subjekti as gjatë hetimit, por dhe pas kalimit të barrës së provës nuk provoi bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

6. Apartament banimi me sip. 92 m², në Lagjen nr. ** Plazh, D.

Vlera e deklaruar: 30.000 euro.

Pjesa në përqindje: zotëron ½ pjesë.

Burimi i krijimit: subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi.

Deklarimi në DPV²⁰: pakësuar gjendja *cash* e akumuluar në vite.

Mënyra e fitimit: me kontratën e shitblerjes datë 15.2.2014.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. ****, datë 15.2.2014, me palë shitëse shtetasin A.T dhe palë blerëse shtetasin E.S, për blerjen e një apartamenti me sip. 80 m², me nr. pasurie ****+*-**, z. k. ***, Lagjja nr. **, Durrës; çmimi i shitjes në shumën 30.000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale;
- certifikatë pronësie të pasurisë “apartament” me sip. 80 m², me vendndodhje në Durrës, në emër të shtetasve E dhe E. S, lëshuar më 9.5.2014.

6.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

ZQRPP-ja²¹ ka konfirmuar se në emër të shtetasve E dhe E. S është regjistruar në bashkëpronësi pasuria apartament, ndodhur në Lagjen nr. **, Durrës, i blerë me kontratë shitblerjeje me vlerë 30.000 euro.

²⁰DPV-ja e vitit 2006.

²¹Me shkresën nr. *** prot., datë 6.11.2017, bashkëngjitur përgjigjja e ZVRPP-së Durrës, drejtuar ILDKPKI-së.

OSHEE-ja²² informon se në emër të shtetasit E. F.S, referuar sistemit të faturimit në zonën Plazh, Njësia nr. **, identifikohet kontrata e furnizimit me nr. DU*A***, në kategorinë familjare, me status aktiv normal.

Në dosjen e ILDKPKI-së është administruar kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 26.7.2005, me palë sipërmarrëse shtetasin A. T dhe palë porositëse shtetasin E. S, për porositjen e apartamentit me sip. 98 m², me vlerë 30.000 euro, ndodhur në Lagjen nr. **, Durrës. Lidhur me mënyrën e shlyerjes së çmimit, në kontratë është parashikuar se është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale.

Për herë të parë kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2006, ku shpjegon se ka shtuar pasurinë me një apartament me sip. 80 m², në Lagjen nr. **, Plazh, Durrës me kontratën e sipërmarrjes, në shumën 30.000 euro.

Kontrata e sipërmarrjes është nënshkruar më 26.7.2005 dhe pagesa është shlyer e plotë sipas kësaj kontrate.

⊗ Subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2005 pagesën e kryer sipas kësaj kontrate.

Komisioni ka kërkuar informacion pranë Gjykatës së Lartë për ndonjë rast konflikti interesi të subjektit me shitësit e pasurive të paluajtshme, në lidhje me të gjitha pasuritë e paluajtshme të blera nga subjekti. Blerja e pasurive është bërë gjatë periudhës që subjekti ka ushtruar detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Lartë²³ ka depozituar informacion për procese gjyqësore të shqyrtuara, me palë shitësit e pasurive të subjektit, sipas kërkesës së Komisionit.

✓ Nga informacioni i ardhur nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të kishte qenë anëtar në trupat gjykues që kishin shqyrtuar çështjet e këtyre subjekteve.

6.2 Analiza financiare

Njësia e Shërbimit Ligjor ka kryer analizën financiare për të vlerësuar mundësinë e blerjes me burime të ligjshme të pasurisë apartament në datën 26.7.2005.

Në lidhje me të ardhurat janë përlllogaritur nga paga për periudhën janar - korrik 2005, nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit.

Në konsideratë janë marrë edhe të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë “truall plus ndërtim” në proces, në Gjirokastër, sipas kontratës së datës 26.1.2005. Referuar dokumentacionit të administruar në dosje për këtë pasuri, ka rezultuar se në datën 14.8.2000, shtetasit H. K dhe E.S kanë firmosur një aktmarrëveshje, ku të ndërtojnë mbi të dy trojet një objekt funksional të përbashkët sipas lejes së ndërtimit.

Të ardhurat nga shitja e pasurive në emër të shtetasve H dhe A.K (sip. 34 m² truall) dhe E dhe Evjeni Sinojmeri (sip. 165 m² truall) me kontratën e shitblerjes datë 26.1.2005, në shumën 3.900.000 lekë, subjekti ka deklaruar të gjithë shumën si të përfituar prej saj dhe bashkëshortit në DPV-në e vitit 2005. Për efekt të analizës, shuma totale u pjesëtua sipas sipërfaqes në metra katrorë në pronësi të palëve.

²²Me shkresën nr. *** prot., datë 15.10.2019.

²³Me shkresën nr. *** prot., datë 5.3.2021.

Në lidhje me shpenzimet janë përlogaritur shpenzime jetese dhe shpenzimet e kësteve të kredisë marrë në “Raiffeisen Bank” (në vitin 2004), për periudhën janar – korrik 2005.

Sa i përket gjendjes së deklaruar të kursimeve *cash*, referuar deklaratave periodike, subjekti e ka pakësuar gjendjen *cash* vetëm në vitin 2006, ku edhe ka deklaruar blerjen e pasurive, për pasojë gjendja *cash* nuk është pakësuar gjatë vitit 2005, por është shtuar sipas deklarimit në DPV-të për muajt respektivë.

Përshkrimi	26.7.2005
Apartament me sip. 80 m ² , P, Durrës	3 711 090
Diferencë likuiditeti	4 458 186
Gjendje <i>cash</i>	8 419 033
Likuiditete banke	-
Pasuri <i>neto</i>	8 169 276
Të ardhura subjekti i rivlerësimit	947 259
Të ardhura bashkëshorti	297 975
Të ardhura nga shitja e “truall plus ndërtesë”	3 233 668
Total të ardhura	4 478 903
Shpenzime jetese	255 633
Shpenzime këste kredie	165 970
Shpenzime udhëtimi	-
Total shpenzime	421 603
Rezultati	- 4 111 976

Nga analiza financiare, referuar tabelës më sipër, duket se subjekti nuk justifikon me burime të ligjshme pasurinë e blerë sipas kontratës, pasi ka rezultuar me një balancë negative në shumën **- 4.111.976 lekë**.

Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Kushtetutës.

6.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, në përgjigjen e rezultateve të hetimit të datës 21.4.2021, nuk ka dhënë shpjegime, si dhe nuk ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me burimin e krijimit për këtë pasuri.

6.4 Analiza ligjore

Për sa më sipër, subjekti as gjatë hetimit por edhe pas kalimit të barrës së provës nuk provoi bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

7. Obligacione²⁴ në shumën totale 9.600.000 lekë, me afat maturimi 10-vjeçar, pjesa takuese 1/2

²⁴Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: vërtetim për blerje obligacioni në tregun primar, nënshkruar në datën 24.1.2014, ndërmjet shtetasit E. S dhe Bankës Kombëtare Tregtare, pjesëmarrës në ankandin nr. *, afat 10 vjet, shuma 2.000.000 lekë, me interes 9.25 %, i pagueshëm çdo 6 muaj; vërtetim për blerje obligacioni në tregun primar, nënshkruar në datën 25.4.2014 ndërmjet shtetasit E. S dhe Bankës Kombëtare Tregtare, pjesëmarrës në ankandin nr. *, afat 10 vjet, shuma 3.000.000 lekë, me interes 9.34 %, i pagueshëm çdo 6 muaj; vërtetim për blerje obligacioni në tregun primar, nënshkruar në datën 23.4.2015 ndërmjet shtetasit E.S dhe B. K.T, pjesëmarrës në ankandin nr. *, afat 10 vjet, shuma 1.600.000 lekë, me interes 8.93%, i pagueshëm çdo 6 muaj; vërtetim për blerje obligacioni në tregun primar, nënshkruar në datën 24.7.2015

Burimi i krijimit: në DPV-në e vitit 2014 ka deklaruar se nga të gjitha kursimet e deklaruara në vite, një sasi prej 5.000.000 lekësh është investuar në obligacione me maturim 10-vjeçar; në DPV-në e vitit 2015 ka deklaruar se nga të gjitha kursimet e deklaruara në vite, një sasi prej 9.600.000 lekësh është investuar në obligacione me maturim 10-vjeçar.

Obligacionet kanë interesa të ndryshme, si vijojnë: vlera 3.000.000 lekë me interes 9.34%; vlera 1.600.000 lekë me interes 8.93 %; vlera 3.000.000 lekë me interes 8.9 %; vlera 2.000.000 lekë me interes 9.25 %.

7.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

Banka Kombëtare Tregtare sh. a.²⁵ konfirmon se shtetasi E. S ka të investuar në obligacione pranë kësaj banke fondet me të dhënat:

- vlera 2.000.000 lekë, datë maturimi 24 - janar – 14;
- vlera 3.000.000 lekë, datë maturimi 25 – prill – 14;
- vlera 1.600.000 lekë, datë maturimi 23 - prill – 25;
- vlera 3.000.000 lekë, datë maturimi 24 - korrik - 25.

7.2 Analiza financiare

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni ka rezultuar se subjekti ka deklaruar pakësim të të gjitha kursimeve *cash* në vitin 2006. Në tabelën vijuese paraqiten vlerat e likuiditeteve në bankë dhe kursimeve *cash* të deklaruara në DPV-të e viteve 2006 – 2015.

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Total Likuiditete	53 444	623 820	5 014 105	1 126 727	1 086 447	5 014 087	5 263 311	7 175 088	9 388 736	11 389 733
Gjendje cash	0	400 000	4 900 000	1 000 000	1 000 000	3 900 000	4 038 063	6 038 063	4 338 063	1 788 063
Likuiditete ne banke	53 444	223 820	114 105	126 727	86 447	1 114 087	1 225 249	1 137 025	5 050 673	9 601 670

Referuar analizës ka rezultuar se:

- ✓ Subjekti ka pasur mjaftueshëm gjendje *cash* të deklaruar për ta investuar në obligacione. Nga analizimi i të dhënave, shuma totale e obligacioneve ka rezultuar 5.000.000 lekë, nga ku vlera prej 1.000.000 lekësh ka qenë bono thesari e investuar që në vitet 2011 – 2014.
- ✓ Subjekti ka pasur mjaftueshëm gjendje *cash* të deklaruar për të depozituar shumën prej 4.500.000 lekësh, më 17.3.2015.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se:

- ⊗ Në lidhje me ligjshmërinë e këtyre fondeve, nga analiza financiare duket se subjekti ka rezultuar me balancë negative për të përballuar shpenzimet dhe për të justifikuar kursimet *cash* dhe likuiditetet në bankë si vijojnë: për vitin 2007 në shumën **691.358 lekë**; për vitin 2008 në shumën **126.374 lekë**; për vitin 2010 në shumën **112.730 lekë**; për vitin 2011 në shumën **1.532.858 lekë**; për vitin 2015 në shumën **564.010 lekë**; për vitin 2016 në shumën **843.700 lekë**.
- ⊗ Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* burimin e krijimit për këto likuiditete.

ndërmjet shtetasis E.S dhe B.K.T, pjesëmarrës në ankandin nr. *, afat 10 vjet, shuma 3.000.000 lekë, me interes 8.9 %, i pagueshëm çdo 6 muaj.

²⁵Me shkresën nr. *** prot., datë 1.11.2019.

- ⊗ Subjekti nuk i justifikon plotësisht me burime të ligjshme kursimet dhe shtesën e likuiditeteve në vite.

Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

7.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, në përgjigjen e rezultateve të hetimit të datës 21.4.2021, nuk ka dhënë shpjegime shteruese, si dhe nuk ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me burimin e krijimit për investimet në bono thesari.

7.4 Analiza ligjore

Për sa më sipër, subjekti as gjatë hetimit, por edhe pas kalimit të barrës së provës nuk provoi bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për investimet e kryera në bono thesari, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar investimet në bono thesari.

Të dhëna konfidenciale

8. Kursime familjare²⁶ në shumën 40.000 USD, dërguar djalit S. S, i cili jeton në Boston, SHBA, për nevojat e tij familjare – kërkesa nga z. E.S për transfertë fondesh, datë 10.5.2016, në “Raiffeisen Bank”

Burimi i krijimit: subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi të kësaj shume në deklaraten *Vetting*.

Deklarimi në DPV: në vitin 2016 është deklaruar pakësim pasurie me 40.000 USD, shumë që i është dërguar, nëpërmjet bankës, për nevoja familjare djalit S.S, i cili jeton në Boston, SHBA.

8.1 Analiza financiare

Komisioni kreu analizën financiare për periudhën janar – maj 2016, e paraqitur në tabelën vijuese. Janë marrë në konsideratë të ardhurat nga pagat e subjektit, bashkëshortit dhe djalit, si dhe të ardhurat nga interesat e obligacioneve për këtë periudhë. Gjithashtu, janë përllogaritur shpenzimet e jetesës për udhëtime, këstet e kredisë, si dhe është pasqyruar transferta prej 40.000 USD, dërguar djalit në SHBA.

Në zërin likuiditete janë pasqyruar gjendjet e bankave deri në datën 6.5.2016, si dhe shumat *cash* të deklaruara nga subjekti.

Përshkrimi	1.1.2016 - 6.5.2016
Pasuri	-1 337 970
Diferencë likuiditeti	-1 337 970
Likuiditete (fund viti.)	10 385 096
Gjendje <i>cash</i> ²⁷	333 333

²⁶Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës kërkesë për transferim fondesh datë 10.5.2016 në “Raiffeisen Bank”, me të cilën shtetasi E. S transferon shumën 40.000 USD në llogari të shtetasit S. S, me përshkrimin ndihmë ekonomike djalit, me burim fondesh, kursime familjare.

²⁷Subjekti ka deklaruar në DPV se ka shtuar kursimet me vlerë 1.000.000 lekë. Gjendja *cash* është përllogaritur në përpjesëtim me muajt në të cilët është kryer analiza financiare.

Likuiditete në bankë	10 051 763
Pasuri neto	-1 337 970
Të ardhura	2 086 149
Të ardhura subjekti	464 348
Të ardhura bashkëshorti	788 892
Të ardhura E. S.	474 200
Të ardhura nga interesat e depozitave	358 709
Shpenzime	5 638 083
Shpenzime jetese	235 092
Shpenzime udhëtimi	176 527
Këste kredie "Raiffeisen Bank"	94 864
Dhuratë djalit në SHBA 40.000 USD	5 131 600
Rezultati financiar	-2 213 964

Për sa më sipër rezultoi se:

⊗ Subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për krijimin e kursimeve, pasi ka rezultuar me balancë negative në shumën **2.213.964 lekë**.

⊗ Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* burimin e krijimit të këtyre kursimeve.

Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Kushtetutës.

8.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, në përgjigjen e rezultateve të hetimit të datës 21.4.2021, nuk ka dhënë shpjegime shteruese, si dhe nuk ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me burimin e krijimit për këto kursime të deklaruara.

8.3 Analiza ligjore

Për sa më sipër, subjekti, as gjatë hetimit por edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk provoi bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e këtyre shumave, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e këtyre kursimeve.

Deklarime të djalit të subjektit, E.E.S, i cili ka deklaruar se disponon pasuri të regjistruar veçmas dhe është në të njëjtën certifikatë familjare me subjektin

9. Automjet²⁸ tip "V. P", prodhim i vitit 2002, blerë në vitin 2009

Vlera e deklaruar: 5.000 euro.

Pjesa në përqindje: zotërues djali i subjektit 100%.

Burimi i krijimit: blerë me të ardhurat e familjes së deklaruar nga nëna/subjekti në pjesën e parë të kësaj deklaratë.

Deklarimi në DPV²⁹: subjekti ka deklaruar se e ka blerë automjetin në shumën 5.000 euro, për djalin E.S. Pakësuar gjendja *cash* e deklaruar në vitet e mëparshme.

²⁸Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 18.5.2009, me palë shitëse shtetasin E.K dhe palë blerëse shtetasin E.S për blerjen e automjetit tip "V", me numër shasie, ***, me targa TR *** F, me vlerë 5.000 euro. Shuma e blerjes së automjetit i është likuiduar shitësit nga blerësi jashtë zyrës noteriale.

Bashkëngjitur certifikata e pronësisë nr. TR***, datë 20.5.2009, e automjetit të sipërcituar me targa të ndryshuar TR *** S.

²⁹DPV e vitit 2009.

Mënyra e fitimit: blerë me kontratën e shitblerjes datë 18.5.2009.

9.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

DPSHTRR-ja³⁰ konfirmon se shtetasi E. S ka në pronësi automjetin me targa TR *** S, nga ku rezulton se çmimi i blerjes së pasurisë është ai që konfirmohet në kontratën e sipërpërmendur.

Nga aktet bashkëlidhur ka rezultuar se çmimi i blerjes së pasurisë është ai që konfirmohet në kontratën e sipërpërmendur.

9.2 Analiza financiare

Referuar analizës financiare për vitin 2009 (shihni tabelën përmbledhëse) ka rezultuar se subjekti ka pasur gjendje kursimesh *cash* të deklaruara deri në fund të vitit 2008, shumën 4.900.000 lekë. Në DPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar se ka pakësuar kursimet për blerjen e automjetit.

9.3 Analiza ligjore

Trupi gjykues, në analizë të deklaramëve të subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratat periodike, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, konstaton se djali i subjektit ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, ekzistencën e kësaj pasurie, mënyrën e fitimit, burimin e krijimit të saj, si dhe ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

10. Automjet³¹ tip “F.F”, deklaruar nga djali i subjektit E.S

Vlera e deklaruar: 9.000 euro.

Pjesa në përqindje: pjesa takuese ½ pjesë në bashkëpronësi me vëllanë.

Burimi i krijimit: blerë me të ardhurat nga puna sezonale dhe me kursimet e familjes.

Deklarimi në DPV³²: në DPV-në e vitit 2011, djali E.S ka deklaruar se e ka blerë automjetin në bashkëpronësi me vëllanë, me të ardhura nga puna e përbashkët “*part-time*” gjatë viteve të shkollës dhe nga dhurata të viteve të fëmijërisë.

Mënyra e fitimit: blerë me kontratën e shitblerjes datë 22.5.2010.

10.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

DPSHTRR-ja³³ konfirmon se shtetasi E. S ka në pronësi automjetin me targa TR *** T deri më 25.1.2017. Nga dokumentacioni bashkëlidhur ka rezultuar se zhdoganimi i automjetit është paguar nga pala shitëse dhe çmimi i blerjes së pasurisë është ai që konfirmohet në kontratën e sipërpërmendur.

Ky automjet është blerë nga pronari i mëparshëm (znj. V. K) në shumën 5.085 euro dhe vlerë zhdoganimi 258.044 lekë. Në total shuma e paguar është 964.859 lekë.

10.2 Analiza financiare

³⁰Me shkresën nr. **** prot., datë 8.10.2019.

³¹Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën:

Kontratë shitblerjeje automjeti, nr. ***, datë 22.5.2010, me palë shitëse shtetasen V. K dhe palë blerëse shtetasit E dhe S.S, për blerjen e automjetit tip “F.F”, me nr. shasie, ***, me vlerë 900.000 lekë, dhe se palët janë likuiduar për këtë shumë me njëri-tjetrin.

³²DPV e vitit 2011.

³³Me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2019.

Në lidhje me burimin e deklaruar si të ardhura nga puna *part-time* dhe nga dhurata të përbashkëta gjatë fëmijërisë, subjekti nuk ka depozituar asnjë dokument provues.

Për sa më sipër rezultoi se:

- ⊗ Subjekti nuk ka depozituar dokumentacion mbi të ardhurat e përfituara nga puna sezonale e fëmijëve.
- ⊗ Për rrjedhojë, nuk provohen me dokumentacion burimet e ligjshme për blerjen e pasurisë.

Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjekti njoftohet se ka barrën e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

10.3 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe analiza ligjore

Subjekti, në përgjigjen e rezultateve të hetimit të datës 21.4.2021, nuk ka dhënë shpjegime shteruese, si dhe nuk ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me burimin e krijimit për këtë automjet.

10.4 Analiza ligjore

Për sa më sipër, subjekti, as gjatë hetimit por edhe pas kalimit të barrës së provës nuk provoi bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

Deklarime të djalit të subjektit S.S, në rubrikën të dhëna konfidenciale, shkëputur nga certifikata familjare me subjektin në datën 30.5.2013

11. Dhuratë në vlerën 15.000 USD, nga gjyshërit A dhe F.S, me rastin e largimit për në SHBA – dërguar nëpërmjet “Raiffeisen Bank”, më 22.8.2014

Në lidhje me këtë dhurim, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar burimet e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e këtyre shumave, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

11.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, në përgjigjen e rezultateve të hetimit të datës 21.4.2021, nuk ka dhënë shpjegime, si dhe nuk ka depozituar dokumentacion provues në lidhje me burimin e ligjshëm për shumën e dhuruar nga gjyshërit.

11.2 Analiza ligjore

Nisur nga deklarimi *Vetting* i dhuratës me vlerë 15.000 USD, në përputhje me nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, subjektet kanë detyrimin të depozitojnë dokumentacion justifikues për burimet e ligjshme të dhuruesve. Pas kalimit të barrës së provës nuk u provuan burimet e ligjshme të dhuruesve, në përputhje me çfarë parashikon ligji.

Tabela e analizës financiare të përgjithshme për periudhën 2003 - 2016

PERSHKRIMI	PASURI	DIFERENCE LIKUIDITETI	DETYRIME	PASURI NETO	TE ARDHURA	SHPENZIME	REZULTATI FINANCIAR
2003	2 619 968	2 119 968	-	2 619 968	3 290 627	375 456	295 203
2004	12 492 802	689 003	5 000 000	7 492 802	2 491 724	1 461 153	- 6 462 231
2005	8 676 379	5 000 179	-	8 676 379	5 368 356	1 501 902	- 4 809 924
2006	- 4 276 142	-8 907 583	742 218	- 5 018 360	2 144 905	1 417 188	5 746 077
2007	570 376	570 376	- 500 398	1 070 774	2 262 193	1 882 776	- 691 358
2008	4 390 285	4 390 285	184 774	4 205 511	5 889 462	1 810 324	- 126 374
2009	- 3 201 529	-3 887 379	-	- 3 201 529	2 318 166	1 162 972	4 356 722
2010	1 124 177	- 40 280	-	1 124 177	1 968 817	957 370	- 112 730
2011	3 927 640	3 927 640	-	3 927 640	3 420 865	1 026 083	- 1 532 858
2012	979 762	249 224	-	979 762	4 535 125	1 907 545	1 647 818
2013	1 911 776	1 911 776	-	1 911 776	4 296 209	1 308 436	1 075 997
2014	2 213 649	2 213 649	-	2 213 649	3 875 545	1 318 774	343 123
2015	2 000 997	2 000 997	-	2 000 997	3 854 588	2 417 601	- 564 010
2016	1 059 434	1 059 434	-	1 059 434	7 344 371	7 128 638	- 843 700

Konkluzion përfundimtar mbi kriterin e pasurisë

Trupi gjykues, për vlerësimin e kriterit të pasurisë në shpjegimet e subjektit dhe pasi mori në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e ardhur nga ILDKPKI-ja, si dhe dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ i Komisionit, ka konstatuar se znj. Evjani Sinojmeri:

- i. Nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimet e ligjshme të pasurive, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti karakterizohet nga mosdeklarimi në mënyrë të përsëritur të burimeve të krijimit të pasurive të saj.
- iii. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve, në përputhje me germën “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- iv. Ka deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar në krimin e organizuar.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, DSIK-ja ka dërguar një raport³⁴ në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar:

³⁴Me nr. *** prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar me vendimin nr. **, datë 30.3.2021, të KDZH-së.

✓ **Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të znj. Evjeni Sinojmeri.**

Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni i ka kërkuar DSIK-së të përditësojë raportin e subjektit dhe, në përgjigje, ky institucion ka informuar se nuk disponohen informacione shtesë për znj. Evjeni Sinojmeri.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë subjekti i rivlerësimit është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

C. RIVLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në analizimin e:

- raportit³⁵ të hartuar nga Këshillit i Lartë Gjyqësor (KLGJ) për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- formularit të vetëdeklarimit të paraqitur, tri dokumenteve ligjore të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit Evjeni Sinojmeri, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti;
- pesë dokumenteve ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga gjyqtarja Evjeni Sinojmeri

a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari i depozituar nga subjekti rezulton i plotësuar sipas formës standarde, në çdo rubrikë, të nënshkruar rregullisht në çdo fletë të tij. Gjyqtarja Evjeni Sinojmeri ka deklaruar të dhënat duke referuar si periudhë të rivlerësimit vitet kalendarike: 2014 – 2016.

b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Evjeni Sinojmeri: në periudhën maj 2001 – maj 2010 ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Lartë, mandat i cili i ka përfunduar në vitin 2010; në periudhën maj 2010 – gusht 2011 subjekti ka përfituar pagesë kalimtare për t’u emëruar më pas si këshilltare; në periudhën gusht 2011 – shkurt 2013 ka ushtruar detyrën e këshilltares së ministrit të Drejtësisë, për t’u emëruar më pas si gjyqtare; në periudhën shkurt 2013 – aktualisht ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Tiranë.

c) Detyrat e ushtruara 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Gjyqtarja Evjeni Sinojmeri ka deklaruar se në 3 vitet e fundit ka ushtruar detyrën e gjyqtares në fushën e të drejtës civile. Specializime nuk ka.

³⁵Raporti me nr. *** prot., datë 23.4.2019.

Lidhur me ngarkesën sasiore, gjyqtarja Evjeni Sinojmeri ka deklaruar këto të dhëna statistikore:

- numri i çështjeve të caktuara 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës – 1022 çështje;
- numri i çështjeve të përfunduara 3 vitet e fundit të detyrës – 991 çështje;
- numri i çështjeve të mbartura vitin e fundit të ushtrimit të detyrës – 12 çështje.

Në Gjykatën e Apelit Tiranë gjyqtarja Evjeni Sinojmeri, në cilësinë e relatores, ka përfunduar gjithsej 942 çështje.

Të dhëna nga burime arkivore të ish-KLD-së

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtarja Evjeni Sinojmeri ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 27.6.1985. Pas studimeve ka punuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe, më pas, më 2.2.1990, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë deri më 8.2.1996, ku znj. Evjeni Sinojmeri kalon në profesionin e noteres deri më 31.12.2000. Subjekti Evjeni Sinojmeri zgjidhet anëtare e Gjykatës së Lartë për periudhën 2.5.2001 – 2.5.2010. Më pas ka punuar në Ministrinë e Drejtësisë deri më 15.1.2013, ku është dekretuar nga Presidenti i Republikës si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku vazhdon dhe aktualisht.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Evjeni Sinojmeri janë paraqitur gjithsej 6 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (2 ankesa në vitin 2014, 2 ankesa në vitin 2015 dhe 2 ankesa në vitin 2016).

Një ankesë e vitit 2014 është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor. Pesë ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si vijojnë:

- 2 ankesa (1 e vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015) të verifikuara për zvarritje gjykimi janë arkivuar me arsyetimin se pretendimet janë të pabazuara;
- 2 ankesa (1 e vitit 2015 dhe 1 e vitit 2016) të verifikuara për mosrespektim formal ligji janë në vijim të verifikimit deri në përfundim të gjykimit në Gjykatën e Lartë;
- 1 ankesë e vitit 2016 e verifikuar për mosrespektim formal ligji është arkivuar me arsyetimin se pretendimet janë të pabazuara.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Evjeni Sinojmeri, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Analiza e Gjetjeve

Analiza e Gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore të ish-KLD-së.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Gjyqtarja Evjeni Sinojmeri ka njohuri shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në aktet e vëzhguara është konstatuar se identifikon në mënyrë shumë të qartë normën ligjore të zbatueshme dhe e zgjidh çështjen në bazë të saj. Natyra e çështjeve që ka shqyrtuar ka qenë e ndryshme dhe përfshin njohuri të së drejtës civile mbi të drejtën e pronësisë dhe

vendimet e Komisionit të Kthimit të Pronave, mbi të drejtën e detyrimeve kontraktore, mbi të drejtën e punës, mbi të drejtën penale materiale dhe procedurale, si dhe njohuri të së drejtës procedurale civile.

Tipar karakteristik i gjyqtarës Evjeni Sinojmeri është parashtrimi i çështjes dhe argumentet juridike të sintetizuara të gjykatës së shkallës së parë, si dhe qëndrimi i gjykatës së apelit duke konfirmuar ose jo secilën prej tyre, parë edhe në vështrim të shkaqeve të ankimit të ngritura nga palët, me një analizë të detajuar të provave të marra në gjykim.

Gjyqtarja njih dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit siç janë: fuqia e plotë provuese e akteve shkresore, parimi i barrës së provës dhe parimi i mosrefuzimit të zgjidhjes së çështjes me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë dhe ka kundërthënie apo është i paqartë.

Në dy dokumente ligjore të paraqitura, në funksion të arsyetimit të vendimit, gjyqtarja përdor referencë në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë.

Në një rast konstatohet interpretim i ndryshëm nga gjykata e shkallës së parë mbi marrëdhënien e krijuar midis palëve, duke cituar edhe nenin 681 të Kodit Civil për interpretimin e kontratës. Në këtë rast, gjyqtarja ka vlerësuar se marrëdhënia e krijuar nuk është as kontratë porosie dhe as sipërmarrje, por “kontratë për shitjen e sendit në të ardhmen” pasi sendi nuk ka ekzistuar në momentin e parë, por në vonë pas fillimit të posedimit të tij nga paditësja duke cituar edhe nenin 706 të Kodit Civil. Ky interpretim është përkrahur edhe nga Gjykata e Lartë.

Në aktet e vëzhguara u është dhënë përgjigje pretendimeve të paraqitura në ankim.

Arsyetimi i vendimeve orientohet drejt shkaqeve të ankimit apo kërkesave paraprake të paraqitura në gjykim.

Së fundmi, duhet evidentuar se ndër pesë dosjet e vëzhguara, vetëm 1 është ankimuar dhe çështja ndodhet ende për gjykim në Gjykatë e Lartë.

Në tri dokumentet e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit rezulton se është paraqitur ankim për të cilat është vendosur mospranim rekursi.

b) Arsyetimi ligjor

Nga aktet e shqyrtuara rezulton se subjekti i rivlerësimit Evjeni Sinojmeri ka aftësi të dukshme në arsyetimin ligjor. Pjesa arsyetuese hartohet me tekst unik, ku gjen pasqyrim citimi i ligjit dhe në ndonjë rast edhe përmbajtja e tij, por pa e rënduar qartësinë e tekstit. Në një rast subjekti citon edhe ligjin e posaçëm, analiza e të cilit në raport me provat e marra në riçelje të hetimit gjyqësor ka sjellë ndryshimin e vendimit rreth disponimit të padisë.

Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja, ndërsa merr në shqyrtim shkaqet e ankimit, duke argumentuar mbi ekzistencën ose jo të tyre.

Në nxjerrjen e konkluzioneve subjekti i kushton rëndësi analizës së normës ligjore dhe argumentimit logjik.

Gjithashtu, në aktet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme që jepet me tekst të qartë arsyetimi, duke referuar saktë shkakun dhe bazën ligjore. Në çdo rast disponon me vendim për gjykimin në mungesë të palëve. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Znj. Evjeni Sinojmeri, në periudhën e rivlerësimit “8.10.2013 – 8.10.2016”, ka kryer detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Tiranë, detyrë që kryen edhe aktualisht.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Apelit Tiranë, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit “8.10.2013 – 8.10.2016” gjyqtarja Evjeni Sinojmeri ka përfunduar 936 çështje, nga të cilat 243 çështje penale (40 çështje themeli dhe 203 masa sigurimi) dhe 693 çështje civile (503 civile themeli, 8 çështje administrative, 13 çështje për lëshimin e urdhërmbrojtjes, 35 kërkesa për njohje vendimi penal të huaj dhe 123 kërkesa pezullimi/rivendosje në afat).

Sipas gemës “i”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit: *“Në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së apelit i dhomës civile si relator, duhet të ketë në jo më pak se 200 çështje civile me palë kundërshtare”*. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 600 gjykime çështjesh të tilla për 3 vjet. Duke zbatuar këtë rregull, në rastin e subjektit të rivlerësimit Evjeni Sinojmeri konstatohet se ngarkesa e saj sasiore ka qenë nën standardin sasior minimal të parashikuar në Sistemin e Vlerësimit të Gjyqtarëve³⁶.

Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, për gjyqtaren Evjeni Sinojmeri rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga dita e marrjes së akteve me short deri në dhënien e vendimit ka qenë e ndryshme.

Nga analiza e të dhënave në raport me standardet kohore për çështjet penale dhe civile në shkallë të dytë sipas germave “g” dhe “h”, të pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, konstatohet se të pesta çështjet janë përfunduar nga gjyqtarja Evjeni Sinojmeri brenda afateve standarde të gjykimit.

Në tri dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, referuar attributeve të pjesës hyrëse të vendimit, nuk mund të identifikohet kohëzgjatja e gjykimit të tyre.

Si datë e arsytimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në kryesekretari. Lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara, rezultoi se gjyqtarja Evjeni Sinojmeri arsyeton pa vonesa vendimet gjyqësore dhe brenda afatit të parashikuar në dispozitat procedurale penale apo civile.

Në analizimin e aftësisë për të përballuar ngarkesën në punë të gjyqtares Evjeni Sinojmeri mbahet në konsideratë edhe paraqitja e 2 ankesave (1 e vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015) për zvarritje gjykimi, të cilat pas verifikimit janë arkivuar me arsyetimin se pretendimet janë të pabazuara.

Së fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtarja Evjeni Sinojmeri ka pasur ngarkesë sasiore nën standardin sasior dhe ka gjykuar brenda afatit standard të gjykimit në pesë dosjet e vëzhguara. Për tri dokumentet e paraqitura koha e gjykimit nuk identifikohet. Gjithashtu rezultoi se gjyqtarja ka arsyetuar pa vonesa të pesta vendimet gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 tejkalon afatin ligjor në mënyrë të papërfillshme.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

³⁶524 gjykime çështjesh civile me palë kundërshtare.

Gjyqtarja Evjeni Sinojmeri ka aftësi për të kryer shpejt procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjeve, tregues i cili lidhet edhe me ngarkesën sasiore të përballuar. Planifikimi i seancave gjyqësore në çështjet penale (themeli apo e natyrës së ngutshme) rezulton të jetë në respektim të afateve të parashikuara në nenet 249/4 dhe 426 të Kodit të Procedurës Penale.

Në të pesta dosjet e vëzhguara, gjykimet civile dhe penale kanë përfunduar me 1 seancë. Këto të dhëna tregojnë se të gjitha seancat kanë qenë produktive, çfarë tregon aftësi të dukshme të gjyqtarës në menaxhimin e procesit gjyqësor.

Gjyqtarja Evjeni Sinojmeri është e qartë për rolin e Gjykatës së Apelit dhe kryen veprimet e nevojshme procedurale për zgjidhjen e pretendimeve të paraqitura në apelin e palëve. Ndër pesë dosjet e vëzhguara nuk ka pasur asnjë rast kur gjykata ka vendosur riçeljen e hetimit gjyqësor, megjithëse në një çështje ka marrë akte me vendim të ndërmjetëm, por pa riçelur hetimin gjyqësor.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i akteve të përzgjedhura me short është konstatuar se, përgjithësisht, aktet themelore të gjykimit janë të rregullta, por në dosjet gjyqësore disa prej akteve mungojnë.

Në të pesta dosjet e vëzhguara, procesverbali gjyqësor është nënshkruar sipas dispozitave procedurale civile dhe penale, madje i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e trupës gjyqësore. Relatimi i çështjes nga gjyqtarja bëhet verbalisht në seancë nëpërmjet leximit të vendimit të shkallës së parë dhe ankimit.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Evjeni Sinojmeri, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga gjyqtarja Evjeni Sinojmeri dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të gjyqtarës Evjeni Sinojmeri, si dhe as kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nuk ka pasur çështje lidhur me barazinë gjinore, të miturit apo të pakicave. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që gjyqtarja Evjeni Sinojmeri nuk ka respektuar rregullat procedurale, me pasojë cenimin e standardit të gjykatës së paanshme.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format shkresor është konstatuar se komunikimi ka qenë i qartë dhe i rregullt. Gjuha e përdorur në seancë gjyqësore dhe në akte të tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Në analizimin e aftësisë së

komunikimit duhet mbajtur në konsideratë se për gjyqtaren Evjeni Sinojmeri nuk rezultojnë ankesa për cenim të etikës gjyqësore referuar edhe të dhënave nga burimet arkivore të ish-KLD-së.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në dokumentet ligjore nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtarës Evjeni Sinojmeri për të bashkëpunuar me kolegët, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Në periudhën e rivlerësimit, gjyqtarja Evjeni Sinojmeri ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 12 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Këto të dhëna tregojnë se ka marrë pjesë në 17 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare.

RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Komisioni, nga vlerësimi i tri dosjeve të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjeve të shortuara, sikurse është shprehur edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor në raportin e tij, nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional.

DENONCIME

Për subjektin e rivlerësimit janë depozituar 9 denoncime, ku pas analizimit të tyre nga Komisioni, referuar pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se denoncimet nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë shkelje, bazuar në standardet e parashikuara në ligj, në lidhje me kriterin e aftësive profesionale.

Trupi gjykues, pas rivlerësimit të raportit të Grupit të Punës, nuk gjeti *indicie apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.*

Komisioni, vlerësoi të analizojë një element shumë të rëndësishëm, me të cilin është njohur gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit

Komisioni është informuar se subjektit të rivlerësimit i është dhënë nga KLD-ja, për arsye familjare, një leje 2-vjeçare, nga 3 vjet që ka kërkuar, e cila ka përfunduar në datën 31.3.2020. Nga korrespondenca që Komisioni ka pasur me KLGJ-në dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është paraqitur në detyrë që nga data e përfundimit të lejes 2-vjeçare, nga data 1.4.2020 e në vijim.

Subjekti, në komunikimin që ka pasur me Komisionin, ka pretenduar se për shkak të gjendjes së pandemisë globale, si dhe të situatës së saj shëndetësore, e ka pasur të pamundur të udhëtonte, pasi i rrezikohet seriozisht shëndeti. Me këtë pretendim, subjekti ka shpjeguar edhe pamundësinë për të administruar dokumentacionin shtesë, për t’iu përgjigjur pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni, si dhe ka kërkuar pezullimin e procesit të rivlerësimit. Megjithatë,

subjekti nuk ofroi informacion dhe nuk ka specifikuar veprimet hetimore konkrete për të cilat është në pamundësi t'i përmbushë nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, apo nëpërmjet ndihmës së ofruar nga ndonjë anëtar i familjes apo përfaqësuesi ligjor.

Gjykata e Apelit Tiranë ka informuar se me e-mailin e datës 21.3.2020, gjyqtarja ka njoftuar për pamundësinë objektive të paraqitjes në punë. Ndërkohë, subjekti ka pretenduar se ka njoftuar KLGJ-në me e-mailin e datës 20.2.2020, për pamundësinë e paraqitjes në detyrë, në kushtet kur leja e dhënë përfundonte më 31.3.2020.

Në mungesë të një përgjigjeje nga KLGJ-ja, në datën 9.10.2020, subjekti i është drejtuar KLGJ-së me një kërkesë për dhënien e një lejeje shtesë 1-vjeçare. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 530, datë 28.10.2020, ka vendosur të refuzojë kërkesën për dhënie leje shtesë të papaguar, pasi afati maksimal i lejes së lejuar sipas ligjit ishte marrë dhe përfunduar nga subjekti.

Subjekti ka ankimuar vendimin e KLGJ-së në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. 11, datë 2.2.2021, ka shfuqizuar vendimin e KLGJ-së duke e detyruar këtë të fundit që të vlerësojë nëse situata e krijuar nga pandemia dhe situata shëndetësore e subjektit mund të justifikojë kërkesën e saj për leje shtesë, përtej afatit maksimal.

Nga informacioni që disponohet, KLGJ-ja, me vendimin nr. 14, datë 29.3.2021, ka refuzuar përsëri kërkesën për leje shtesë të papaguar për 1 vit, të kërkuar nga subjekti.

Ndërkohë, për sa u shpjegua më sipër, ka rezultuar se subjekti nuk është paraqitur në detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Apelit Tiranë, që nga data 1.4.2020, si dhe ka paraqitur një kërkesë pranë KLGJ-së, për një leje shtesë 1-vjeçare, pas 6 muajsh që mungonte në detyrë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion mbështetës pamundësinë objektive për të mos u paraqitur në detyrë.

Komisioni arsyeton se referuar pikës 2, të nenit E, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është parashikuar se: *“... vlerësimi i aftësisë për gjyqtarët, ... përfshin aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj”*.

Referuar germës “a”, të pikës 2, të nenit 102, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” është parashikuar se: *“Sipas parashikimeve të germave ‘a’ ose ‘c’, të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkeljet disiplinore gjatë ose në lidhje me ushtrimin e funksionit, brenda ose jashtë zyrës, janë në veçanti sjelljet dhe aktet e magjistratit si më poshtë:*

a) mospërmbushja e pajustificuar e detyrimeve për të qenë i gatshëm dhe për t'u paraqitur në detyrë për nevojat e ushtrimit të funksionit pranë gjykatave ose prokurorive, nëse ky detyrim përcaktohet nga ligji ose nga vendimet e organeve kompetente:

Germat “a” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, ka të parashikuar: *“Magjistrati kryen shkelje disiplinore në këto raste:*

a) kur vepron me pakujdesi në ushtrimin e detyrave që rrjedhin nga funksioni, sipas parashikimeve të bëra në pikën 2 të këtij neni; ...

c) në çdo rast tjetër që, në mënyrë të pajustificuar kryen akte dhe sjellje të papërshtatshme gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose që dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë”.

Për sa më sipër, Komisioni arsyeton se mosparaqitja në detyrë e subjektit të rivlerësimit, pa shkaqe të arsyeshme dhe në mënyrë të pajustificuar, si dhe mosveprimi i saj për një periudhë 6-mujore duke mos u paraqitur në detyrën si gjyqtare e Gjykatës së Apelit Tiranë, është një shkelje disiplinore, në vijimësi.

❖ Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkua dokumentacion provues për të justifikuar pamundësinë objektive të paraqitjes në detyrë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin E të Kushtetutës.

Subjekti, në prapësimet e datës 21.4.2021, nuk depozitoi asnjë dokument provues mbi gjendjen shëndetësore, për të justifikuar pamundësinë objektive për të udhëtuar nga SHBA-ja, pas përfundimit të lejes 2-vjeçare të dhënë nga KLD-ja.

Trupi gjykues, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti nuk është paraqitur për të ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, që nga data 1.4.2020, si dhe nisur nga parashikimi ligjor për sa i përket periudhës së rivlerësimit, vlerëson se shkelja disiplinore lidhur me etikën, e ndodhur pas kësaj periudhe është kompetencë vlerësimi e KLGJ-së.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nuk u provuan *indicie* apo elemente që cenojnë figurën e gjyqtares Evjeni Sinojmeri dhe sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme për sa i përket periudhës së rivlerësimit.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat e administruara nga Komisioni, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, arrin në konkluzionin se:

Subjekti i rivlerësimit nuk arriti t'i provojë trupit gjykues të kundërtën e rezultateve të hetimit, konkretisht nuk provoi: (i) burimet e ligjshme financiare për krijimin e pasurive të deklaruara në deklaratën *Vetting*; duke u gjendur në parashikimet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë në përputhje me pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe

në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Evjeni Sinojmeri, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 30.4.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha